# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-443525**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Reagimi - Kërcënimi me vdekje i gazetarit Osman Stafa/ PD: Narkopolicia nuk do ta fitojë betejën me fjalën e lirë! |
| ADRESA | `https://www.syri.net/politike/916602/kercenimi-me-vdekje-i-gazetarit-osman-stafa-pd-narkopolicia-nuk-do-ta-fitoje-betejen-me-fjalen-e-lire/` |
| BURIMI | syri.net |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 14 shtator 2026, 14:58:21 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 14 shtator 2026, 14:55:24 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `fbf22f9c7aff244427de43bf26b694a070632e60bdec4fd330045d619dd3886f` |
| TEKSTI | `0b5eed097c17128226625e84215cce9811af81018f47c06424163e078984da83` |
| PAMJA | `9b53794cf6f58dc63d4495ad505441aaaf56029e3c95d1421374fc0de55dc438` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `da9bc93ef786f004f633a4e78cf1075f3d9a7ef9523ee30a4035e3530f49ac68` |
| E MËPARSHMJA | `f2a3150169d7909ccc9b5410903b8bdb28bef08f0dedfca4dca9d3ec8e8e2922` |
| RRËNJA MERKLE | `c5c495e1993bed01ae9e3c22701c0f0e7f56228ef65729414d07abaefa87f787` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/da9bc93ef786f004f633a4e78cf1075f3d9a7ef9523ee30a4035e3530f49ac68`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



IRENA BEQIRAJ
Fashizmi nuk duhet kërkuar tek revolta e protestuesve por në Kuvend!



AGIM XHAFKA
Dialog me mbesën



# Kërcënimi me vdekje i gazetarit Osman Stafa/ PD: Narkopolicia nuk do ta fitojë betejën me fjalën e lirë!

16:55, 14/09/2026

ZMADHO TEKSTIN

+ A[a] -

Partia Demokratike nëpërmjet një deklarate shtypi ka dënuar me forcë kërcënimin me vdekje ndaj gazetarit të Neës24, Osman Stafa, pas publikimit prej tij të pamjeve nga protesta përpara Kuvendit.

Ne postimin e shpërndarë nga zëdhënësja e PD Floriana Garo thuhet gjithashtu se, "kërcënimi ndaj gazetarit pas publikimit të këtyre pamjeve nuk mund të trajtohet si një episod i zakonshëm". "Ai duhet hetuar urgjentisht, duke përcaktuar jo vetëm autorin e mesazhit, por edhe nëse kërcënimi lidhet me ekspozimin e punonjësve të policisë dhe me veprimtarinë profesionale të gazetarit".

**DEKLARATË E PARTISË DEMOKRATIKE**

Partia Demokratike dënon me forcë kërcënimin me vdekje ndaj gazetarit të Neës24, Osman Stafa, pas publikimit prej tij të pamjeve nga protesta përpara Kuvendit.

Katër personat me veshje civile të dokumentuar në pamje gjatë ndalimit të një protestuesi janë punonjës policie. Fakti që efektivë të Policisë së Shtetit ndërhyjnë pa uniformë dhe pa shenja identifikuese ndaj protestuesve paqësorë ngre shqetësime serioze për veprime të paligjshme dhe përpjekje për t'iu shmangur përgjegjësisë.

Kërcënimi ndaj gazetarit pas publikimit të këtyre pamjeve nuk mund të trajtohet si një episod i zakonshëm. Ai duhet hetuar urgjentisht, duke përcaktuar jo vetëm autorin e mesazhit, por edhe nëse kërcënimi lidhet me ekspozimin e punonjësve të policisë dhe me veprimtarinë profesionale të gazetarit.

Kjo ngjarje është pjesë e një klime gjithnjë e më armiqësore ndaj fjalës së lirë, të krijuar nga një qeveri që i përgjigjet denoncimit me presion, intimidim dhe frikësim.

më të lexuarat

Modeli Kayo, Bozdo: Janë krijuar 20 kompani, kanë marrë monopolin në disa fusha

Zhupa: Nga shkollat me turne te emigrimi i të rinjve, problemet mbeten të njëjta, fëmijët paguajnë çmimin

'Mafia emëron ministrat në qeverinë Rama', Kepi: E kanë lehtë të gjejnë personin e duhur për aferat e tyre

Berisha në Konventën Republikane në Dallas - Takime me drejtues të Departamentit të Drejtsisë, Takime me senatore

Shqiptari nga Anglia: Rama dha urdhër të mos hyjmë në shesh! Të rrimë këtu derisa ta shporrim nga zyra antishqiptarin

Muzeu hebraik në Vlorë/ Nezini: Godina i përket Klubit Labëria, po zhduket historia

Kur gazetarët kërcënohen sepse dokumentojnë sjelljen e policisë, synimi është i qartë: të heshtet media, të fshihen abuzimet dhe qytetarët të privohen nga e drejta për të ditur të vërtetën.

Partia Demokratike kërkon:

-identifikimin dhe vënien përpara drejtësisë të autorit të kërcënimit;

-zbardhjen e lidhjes së mundshme ndërmjet kërcënimit dhe pamjeve të publikuara;

-identifikimin zyrtar të katër punonjësve të policisë dhe sqarimin e urdhrave mbi bazën e të cilëve kanë vepruar pa uniformë;

-vlerësimin e rrezikut dhe garantimin e mbrojtjes së gazetarit Osman Stafa.

Heshtja ose zvarritja nga institucionet do të përbënte mbrojtje politike për kërcënuesit dhe një mesazh frikësues për çdo gazetar që guxon të dokumentojë abuzimet e pushtetit.

Partia Demokratike qëndron në solidaritet të plotë me Osman Stafën dhe me çdo gazetar që mbron interesin publik.

Narkopolicia nuk do ta fitoje betejen me fjalën e lirë!

'Po blejnë influencë te zyrtarët e BE', Xhaferri: Rama i mori 17 miliardë lekë Universitetit të Tiranës për Kolegjin e Evropës

SYRI TV/ Karakaçi: TEC-et do jenë pronë e KESH, ERE ka shtyrë licencimin e tyre

'Diaspora nuk ka për tia falur Ramës! Shqiptarët e bashkuar pushteti i tmerruar! Dita e 105 e protestës në foto

© SYRI.net

Lexo edhe:


'Rama jepe dorëheqjen'/ Berisha poston videon: Gjimnazistët i japin përgjigje Padrinos për dhunën ndaj qytetarit


Edhe sa do përpëlitet SPAK përballë aferës Rama-Yeffet?


BE: I takon Kushtetueses ta gjykojë formimin e Qeverisë dhe të Kuvendit

TË NGJASHME

SYRI TV/ Pagat e magjistratëve, debate te Ekonomia, Rama justifikohet me rëndesën në buxhet

Tabaku: Afera KAYO godet procesin e integrimit, "sistemi Rama" po pengon të ardhmen europiane të Shqipërisë

Seanca në Gjykatën e Lartë/ Nuk gjykohet kryebashkiaku, por individi Erion Veliaj, i akuzuar për korrupsion

Mbipopullimi në shkollat e Tiranës/ Lamaj: Investime të pabarabarta në arsim, po shpopullohen periferitë

Babëzia e Ramës si origjinë e krizës së pagave me gjyqtarët

‘Kreu i 5D, Erjon Veliaj pret lirinë’, Këlliçi: A do ta mbrojë Gjykata e Lartë zyrtarisht korrupsionin?

Apeli i GJKKO-së pranon kërkesën e Metës: Do gjykohet jashtë kafazit të qelqtë



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.